



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Date: 13.09.2023

Nr. 02-785

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d) të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në pajtim me nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, të datës: 03.09.2008, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e grupit punues për hartimin e Draft-Rregullorës

- 1) Formohet grupi punues për hartimin e Draft-Rregullorës që përcakton qartë rregullat, kriteret, kushtet dhe procedurat për shpalljen e sportistëve të (vitit) në sport për Komunën e Shtimes, me këtë përbërje:
 - 1.1 Fatmire Ferati – kryesuese e grupit.
 - 1.2 Idajet Rexhepi - anëtar
 - 1.3 Bajram Gashi - anëtar
 - 1.4 Lulzim Sahiti – anëtar
 - 1.5 Meriton Baftiu - anëtar (klubet sportive).
 - 1.6 Zenel Shabani – anëtar (klubet sportive).
- 2) Grupi punues si në pikën 1 të këtij vendimi është përgjegjës të draftoj Rregulloren që përcakton rregullat, kriteret, kushtet dhe procedurat për shpalljen e sportistëve të (vitit) në sport për Komunën e Shtimes dhe ta finalizoj këtë akt normativ në një afat sa më të shkurtër kohor.
- 3) Ky akt normativ duhet të draftohesh dhe finalizohet në harmoni dhe në pajtim me dispozitat ligjore dhe nën ligjore të kësaj fushe që janë në fuqi.
- 4) Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport.
- 5) Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

➤ Iu dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Anëtarëve të Grupit Punues
- Arkivit të Komunës

